



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.10.2025
Numër Protokolli: 6583/2025

A.nr.1513/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1513/2025, të datës 31.07.2025, të parashtruar nga ankuesja L.S, kundër organit të punësimit: Inspektorati Qendror i Punës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1513/2025, të datës 31.07.2025, të parashtruar nga ankuesja L.S.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, L.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 31.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 10.07.2025 lidhur me rezultatet përfundimtare në procedurën Nr.Ref: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës *Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës* në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1513/2025, **sepse:**

Nga administrimi provat e çështjes rezulton se Inspektorati Qendror i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, numri i kërkuar nëntë (9), klasa profesional 1, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës rrjedhë se ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa, në fazën e vlerësimit profesional ka arritur në total 74 pikë.

Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës më datë 10.07.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare, ashtu që, 18 kandidatë janë shpallur të suksesshëm, gjegjësisht ankuesja është renditur e 12-ta me 74 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton njoftimin e rezultateve përfundimtare, më pretendimet së vlerësimi është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe po ashtu konkursi është shpall nga Ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati N.G, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli më Vendimin A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, ka anuluar në tërësi procedurën e pranimi nr. ref: RN00017340.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1513/2025, të datës 31.07.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këtë procedurë si një nga kërkesat e ankueses në petitut të ankesës, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1513/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1513/2025, të datës 31.07.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1513/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses L.S;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.